



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 38
Prishtinë, më 12.10. 2016, në orën 12:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, kryetar, Fadil Demaku, nënkryetar i parë; Rexhep Selimi, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami Nuredin Ibishi, Zafir Berisha- anëtarë.

Rrustem Berisha, nënkryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Mungoi: Bojan Mitiq.

Zyrtarët nga Inspektorati Policor i Kosovës: Hilmi Mehmeti, kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës; Miradije Kelmendi, u.d. drejtor i Departamentit të Testit të Integritetit dhe Kushtrim Hodaj, hetues.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Milot Rexhepi, DCAF; Kristian Ramaj, praktikant.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

Raportimi i kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës, z. Hilmi Mehmeti.

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryesuesi, fillimisht theksoi se qëllimi i këtij takimi është raportimi i kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës, z. Hilmi Mehmeti dhe ia dha fjalën, z. Mehmeti, për të vazhduar tutje me pyetjet nga ana e anëtarëve të Komisionit.

Hilmi Mehmeti (kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës), mori fjalën duke theksuar disa pika kyçe të raportit të Inspektoratit Policor të Kosovës, para Komisionit. Mirëpo, raportin, që z. Mehmeti e prezantoi para Komisionit, i përket periudhës që kur ka marrë mandatin si kryeshef Ekzekutiv në IPK.

Në periudhën nëntëmuajore (1 janar-30 shtator 2016), në lidhje me trajtimin e ankesave, këtë vit ka rritje të numrit të ankesave, duke krahasuar vitin e kaluar që ishte 896 ankesa, kurse në periudhën janar-shtator, Komisioni ka pranuar 1021 ankesa, pas analizimit nga Divizioni i Ankesave, 622 ankesa janë kthyer në Drejtorinë e Standardeve Profesionale të Policisë së Kosovës dhe nuk janë gjetur elemente të veprës penale, prej grupit tjetër, ankesat kanë shkuar (379 ankesa) në Departamentin e Hetimeve në IPK. Po ashtu, në strukturën organizative të IPK-së, është edhe Departamenti i Inspektiveme, i cili për këtë periudhë ka kryer 5 inspektime të rregullta dhe 3 inspektime të jashtëzakonshme.

Tek Departamenti i Divizionit për Buxhet dhe Financa, në bazë të raportit, shihet se viti 2015-2016, ka pasur një shpëtim të vogël të buxhetit, mirëpo 52.000,00 euro janë marrë nga Ministria e Financave, për shkak të shkurtimeve buxhetore, të cilat kanë ndikuar në mënyrë direkte edhe në punën e IPK-së, për arsye se nga shpenzimet kapitale 29.000 euro janë tërhequr, mirëpo ato janë destinuar për blerjen e armëve.

Gjithashtu, theksoi se nga koha që ka marrë mandatin, është ballafaquar edhe me rikthimin e 4 zyrtarëve të IPK-së, me vendim të formës së prerë nga Gjykata, e që në vendim është përcaktuar edhe kompensimi i pagave të zyrtarëve policorë, në vlerë rreth 50.000,00 euro, për periudhën 3 vjeçare.

Më tutje, theksoi se janë në fazat finale për krijimin e një grupi trajnues për trajnimin e zyrtarëve të IPK-së, me qëllim që të ngremë kapacitetet e inspektorëve të IPK-së. Gjithashtu, çështja e lokacionit është pak problematike, pasi që momentalisht, IPK-ja është e vendosur në Hajvali, ku qytetarët nuk e kanë shumë të lehtë që t'i qasen këtij lokacioni për ankesa, për shkaqe të distancës jo shumë të favorshme nga kryeqyteti. Si rezultat i kësaj, IPK-ja ka bërë disa hulumtime rreth një zone strategjike diku në kryeqytet dhe është gjetur një pozitë shumë e mirë në pjesën ku është i vendosur momentalisht stacioni i autobusëve në Prishtinë, mirëpo për t'u realizuar një gjë e tillë, kanë nevojë për përkrahjen e Komisionit, ku gjithashtu është bërë kërkesë edhe në Komunën e Prishtinës, për të marrë leje, që të ndërtohet objekti, ku do të vendoset IPK-ja.

Për ta informuar opinionin, IPK-ja ka organizuar disa tryeza me qytetarët e Republikës së Kosovës, që kanë pasur si qëllim informimin e tyre në lidhje me punën që bëjnë, si Inspektorat,

si dhe të drejtat që ata kanë për të paraqitur ankesë, në rast se një e drejtë e cila iu garantohet me ligj, nuk përfillet nga zyrtarët e Policisë së Kosovës.

Kryesuesi, mori fjalën dhe kërkoi sqarime shtesë në lidhje me *dualizmat* brenda IPK-së.

Ganimete Musliu, në pyetjet e drejtuara z. Mehmeti, theksoi raste të shumta që zyrtarët policorë, janë edhe vetë shkelës të rregullave të komunikacionit. Ky fakt është i shpeshtë dhe se kjo sjellje është një shembull i keq, sidomos tash pasi hyrjes në fuqi të ligjit ti ri për komunikacionin.

A janë marrë masa ndaj zyrtarëve policorë, që shkelin rregullat e komunikacionit? Mbi çfarë baze është marrë vendimi për shkurtimin e buxhetit dhe a është arsyetuar kjo çështje?

A është bërë ndonjë matje e efikasitetit/kënaqshmërisë së qytetarëve me shqyrtimin e ankesave nga ana e IPK-së?

Rexhep Selimi, duke iu referuar fjalës së z. Mehmeti, që nga momenti i marrjes së detyrës, janë propozuar ndryshime të udhëzimeve administrative, shtroi pyetjet si në vijim: A kanë qenë gabim udhëzimet administrative të mëhershme të nënshkruara nga po i njëjti ministër, që është edhe tani apo ministri ka nënshkruar udhëzime, të cilat nuk kanë qenë të përshtatshme për IPK-në? Kur keni dhënë dorëheqje nga Policia e Kosovës, pasi që është procedurë, që të emërohesh kryeshef Ekzekutiv në IPK? Shihet se ka rritje të ankesave të qytetarëve. A keni mundur ta identifikoni se cila është arsyeja e rritjes së ankesave, përpos vetëdijesimit të qytetarëve? A keni mundur të identifikoni ndonjë shkaktar tjetër që ka ndikuar në rritjen e ankesave? Referuar fjalës së z. Mehmeti, se do të bëhen ndryshime organizative, në kuadër të IPK-së, shtroi pyetjen: Cilat departamente duhen ndryshuar, shtuar apo cilat duhet të hiqen dhe sa ndikon kjo në ndryshimin e Inspektoratit?

Anton Quni, shtroi pyetjet si në vijim: Çka kishit ndryshuar dhe plotësuar, që të përsoset më mirë puna e juaj? Duke marrë parasysh që puna e mëhershme ka qenë zyrtar policor, a do të ndikojë kjo në subjektivitetin e punës tuaj në Inspektorat, pra kur janë në pyetje ish- kolegët tuaj?

Hilmi Mehmeti (kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës), sqaroi se këtu bëhet fjalë për dy departamente që operojnë brenda IPK-së, saktësisht tek hetuesia speciale dhe testi i integritetit, për arsye se nuk ka një mbështetje të qartë në Kodin e Procedurës Penale.

Në lidhje me pyetjen se kur ka dhënë dorëheqje nga Policia e Kosovës, tha se është data 5 maj 2016, një ditë para se të kalojë në IPK. Ndërsa, në përgjigjeje të z. Quni, tha se disa kompetenca janë të tepërta për kryeshefin e IPK-së.

Zafir Berisha, ngriti çështjen për dualizmin brenda IPK-së, që të konkretizohet se për çfarë dualizmash bëhet fjalë, a është fjala për dualizëm politik, dualizëm mes departamenteve apo dualizma të ndikimit nga jashtë në IPK, apo dualizëm i akteve nënligjore, të cilat nuk përputhen mes veti?

Më tutje shtroi çështjen për pranimin e kandidatëve të rinj në konkurset e shpallura nga Policia e Kosovës, gjegjësisht padrejtësive që shpesh janë ngritur nga kandidatët, që për një poenë nuk ka arrit të pranohet kandidati potencial, ku më vonë kalon edhe afati i përzgjedhjes dhe si pasojë nuk mund të pranohen?

Gjithashtu, i ka rastisur të shohë në media se prokurori i Shtetit është ankuar në polici, për shkak të një kërcënimi nga pjesëtari i Policisë së Kosovës. Ky rast ka ndodhur në Prizren. Si mund të vijë deri në atë nivel që prokurori të ankohet në polici? Çka ka ndërmarrë Inspektorati Policor që policët tanë, të mos vijnë deri në këtë nivel, sa të kërcënojnë edhe prokurorët, sepse një gjë e tillë është krejtësisht e papranueshme?

Qerim Bajrami, ngriti çështjen rreth listës së të punësuarve, pasi që nuk e ka paraqitur në raport. Sa janë prej tyre të komitetit jo-shumicë?

Çka keni në plan që të ndërmerrni veprime në terren, që komunitetet jo-shumicë të kenë informata që ekziston IPK-ja dhe të kenë qasje të ankohet tek IPK-ja, posaçërisht ata që nuk e kuptojnë gjuhën shqipe?

Nuredin Ibishi, ngriti çështjen rreth matjes së performancës së disa zyrtarëve, të cilët kanë qenë pjesë e ekipit të kryeshefave paraprakë, të cilët nuk e kanë pasur kualifikimin dhe eksperiencën e duhur për pozitat e caktuara që i kanë. A ka ndodhur diçka e tillë me marrjen e mandatit tuaj?

Ndërsa, sa i përket organogramit, sipas Ligjit të IPK-së, është që kryeshefi i Inspektoratit propozon dhe ministri miraton. Këtu ka ndodhur një ndryshim tek Departamenti për Testin e Integritetit, që më vonë është kthyer në një divizion, pa pëlqimin e ministrit, është bërë një shkelje që nuk është kërkuar miratimi i ministrit për përcaktimin e stafit të Departamentit për Hetime Speciale. Pra, në këtë aspekt, a është bërë një shkelje ligjore dhe ndërhyrje në kompetencat e ministrit apo jo?

Çka duhet që të bëni ju në mënyrë që të jeni më afër qytetarëve, përveç çështjes së dislokimit që është shumë me rëndësi?

A ju mungon diçka nga udhëzimet administrative për të ushtruar detyrën tuaj, në mënyrë të mirëfilltë, konkretisht a ka ndonjë udhëzim i cili ju duhet për funksionim si Inspektorat, e që nuk e keni? Ku ka mbërri Projekti i Binjakëzimit, i mbështetur nga Zyra e BE-së në Kosovë për testin e integritetit, sipas modelit hungarez? Çka do të bëni për përmirësimin e imazhit të Policisë së Kosovës?

Ganimete Musliu, shtroi pyetjen si në vijim: Ankesat që i adresohen IPK-së, nga cili rajon vijnë më së shumti?

Hilmi Mehmeti (kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës), në përgjigje të pyetjeve të parashtruara, tha se nëse i referohemi tabelës, shumica e ankesave janë për trafik, ndërsa sa i përket shkurtimit të buxhetit, tha se shkurtimi i buxhetit nuk është bërë me vendim të Qeverisë.

Ndërsa, sa i përket ankesave të qytetarëve, tha se ankesat online të qytetarëve janë në rritje dhe se prej momentit që ka marrë këtë pozitë, asnjë qytetar nuk është mbetur pa përgjigje.

Në lidhje me pyetjen e z. Selimi, se a ka qenë gabim nënshkrimi i ministrit, tha se nuk ka bërë shkelje, pasi që nuk është gjetur ndonjë gabim. Sa i përket testit të integritetit, tha se testi i integritetit, nuk është qartë i sqaruar në Kodin Penal.

Sa i përket ndryshimit të organogramit, tha se kanë bërë rritje të numrit të divizioneve, pak a shumë janë ato, por është bërë kanalizimi i tyre, është bërë një departament për planifikim, pasi

që nuk e kanë pasur një zyrë ligjore, ndërsa ka dhënë dorëheqje nga Policia e Kosovës, më 5 maj 2016.

Në përgjigje të pyetjeve të parashtruara nga z. Quni, tha se Ligji për IPK-në është i mirë, mirëpo nuk do të thotë që kjo në të ardhmen nuk duhet ndryshuar, disa kompetenca janë të tepërta, mirëpo disa udhëzime duhet ndryshuar.

Nëse iu adresohemi statistikave në numrin e arrestimeve, them se është në avancë, pasi që njëh mirë punën e policisë.

Ankesat e kandidatëve për pranim në Policinë e Kosovës, më shumë kanë të bëjnë me testin e inteligjencës dhe testin fizik, mirëpo është edhe një numër mjaft i madh, çdo vit, që konkurrojnë për pranim në polici, por ankesat e mundeshe i ka trajtuar me kompetencë.

Kryesuesi, pyeti: A ka një listë të vendeve publike që zyrtarët policorë e kanë të ndaluar të shkojnë, qoftë në Kosovë apo jashtë saj, a keni ndonjë shtet që nuk lejohen pjesëtarët e policisë të shkojnë?

Hilmi Mehmeti (kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës), në lidhje me raportin që nuk është në të gjitha gjuhët zyrtare, theksoi se janë duke punuar në gjetjen e një përkthyesi në gjuhën serbo-kroate. Ndërsa, sa i përket zyrtarëve policorë që kanë kaluar nga policia në IPK, theksoi se të gjithë janë me shkollimin e duhur për punën që e kanë, përveç dy zyrtarëve që janë në vitin e fundit të studimeve. Sa i përket zyrave rajonale, duhet të ketë zyra që shfrytëzohen për nevoja operative, që të jenë më afër qytetarëve, për efikasitetin e IPK-së.

Lidhur me grupin punues i cili po punon me testin e integritetit, modeli hungarez, theksoi se nga IPK-ja në këtë grup punues janë dy zyrtarë. Gjithashtu, ka zyrtarë edhe nga Ministria e Arsimit, të mbikëqyrur nga organizata evropiane.

Rexhep Selimi, shtroi pyetjet si në vijim: A keni bërë dorëheqje apo pezullim detyre? A ka zyrtarë që punojnë në IPK, që më herët kanë qenë pjesë në hetim penal?

Hilmi Mehmeti, (kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës), në përgjigje të pyetjeve të z. Selimi, theksoi se ka bërë pezullim, në përputhje me ligjin. Ndërsa, për pyetjen e dytë nuk kam informata, nëse ka zyrtarë në IPK, që kanë qenë pjesë në hetime penale.

Ndërsa, sa i përket z. Nehat Thaçi, i cili është arrestuar nga autoritetet serbe, theksoi se në momentin që e merr pushimin, ka të drejtën e lëvizjes në të gjitha shtetet, pa dallim, duke përfshirë edhe Serbinë.

Fadil Demaku, shtroi pyetjen: Në rastet kur një zyrtar policor i nivelit të lartë, kur del jashtë vendit, a raporton tek eprori që ka lëshuar vendin dhe ku gjendet?

Anton Quni, pyeti: A është e rregulluar çështja e raportimit në rastet kur udhëtojnë jashtë vendit, nga ana e zyrtarëve të policisë?

Rrustem Berisha (nënkryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë), pyeti: Deri ku kanë shkuar hetimet për rastin e vjedhjes në Dhomës së Dëshmive? A ka informacione për këtë dhe a ka ndonjë ndëshkim për zyrtarët policorë?

Zafir Berisha, pyeti: A ka listë të vendeve, lokaleve ku është i ndaluar frekuentimi nga ana e zyrtarëve policorë?

Hilmi Mehmeti (kryeshef Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës), theksoi se për një sërë pyetjesh të shtruara, përgjigje mund të jepeshin nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Ndërsa, sa i përket arrestimit të z. Thaçi, theksoi se janë bërë analizat dhe pasi ka pasur pushimin e aprovuar, ka pasur këtë të drejtë, ndërsa si IPK nuk kanë listë të shteteve, objekteve ku zyrtarët policorë e kanë të ndaluar të shkojnë.

Kushtrim Hodaj (hetues), në përgjigjeje të z. Rustem Berisha, theksoi se rasti i parë që ka ndodhur në vitin 2009, në Prishtinë, sipas ligjit në fuqi, IPK-ja nuk ka pasur të drejtë të zhvillojë hetime penale dhe ky rast nuk është trajtuar, por është trajtuar vetëm në aspektin disiplinor. Vendimi ka qenë që pasi të zbardhet çështja penale, por nuk ka qenë e mundur të jepen masa disiplinore. Ndërsa, sa i përket rastit të dytë që ka ndodhur në Pejë, Inspektorati e ka trajtuar këtë rast dhe ka zhvilluar hetimet për këtë rast, si dhe është ngritur kallëzim penal në Prokurori për zyrtarin policor dhe çështja është trajtuar edhe në gjykatë, ndërkohë kanë rrjedhur disa informata për prova të reja të mundshme dhe është ri-angazhuar përsëri në proces nga IPK-ja dhe janë në proces të shqyrtimit të këtyre provave që janë në progres.

Kryesuesi, falënderoi për raportimin në Komision të zyrtarëve nga Inspektorati Policor i Kosovës, duke shtuar që përkrahja e Komisionit për IPK-në do të jetë në vazhdimësi, në funksion të punës më të mirë të këtij institucioni.

Rexhep Selimi, propozoi që Komisioni të formojë një grup punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës, duke shtuar se rekomandimet e dhëna në legjislaturën e kaluar, nuk janë zbatuar në tërësi.

Kryesuesi, u pajtua më këtë propozim dhe propozoi që Nuredin Ibishi, Qerim Bajrami, Ganimete Musliu dhe Rexhep Selimi, të jenë anëtarë të këtij grupi punues.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë:

VENDIM

Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr.03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, me këtë përbërje: Ganimete Musliu-kryesuese, Nuredin Ibishi, Rexhep Selimi, Qerim Bajrami-anëtarë.

Kryesuesi, kërkoi mbështetjen e Komisionit për të bërë një shkresë për kryetarin e Komunës së Prishtinës, për përshpejtimin e procedurës për ndarjen e një lokacioni për vendosjen e objektit të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Rexhep Selimi, theksoi se për këtë çështje mund të marrë angazhim personal, për të komunikuar me kryetarin e Komunës së Prishtinës, për mundësinë e gjetjes së një lokacioni më të

përshtatshëm për IPK-në. Gjithashtu, theksoi se edhe Stacioni Policor në jug, në qytetin e Mitrovicës, ka nevojë për objekt dhe se një kërkesë e tillë do të mund të bëhej, pasi objekti është gati për t'u shembur dhe është pronë e dikujt tjetër, por jo e Policisë së Kosovës.

Kryesuesi, njoftoi për shkresën drejtuar Kryeministrit nga Kryetari i Kuvendit, lidhur me skadimin mandatit të mbikëqyrësve të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Kjo çështje është shqetësim i përbashkët, pasi këta nuk janë në detyrë, dhe rrjedhimisht, agjencia nuk funksionon si duhet. Më tutje, theksoi se duhet të kërkohet sqarim nga Qeveria, për të gjetur zgjidhje sa më të shpejtë.

Rexhep Selimi, propozoi që fillimisht të bëhet konstatimi që është bërë shkelje për këtë rast në mos-emërime me kohë të mbikëqyrësve në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe më pas të jepet rekomandimi nga Komisioni.

Kryesuesi, propozoi që në mbledhjen e radhës, të ftohet drejtori i Përgjigjëm i Policisë së Kosovës, për të raportuar lidhur me rastin e arrestimit të z. Nehat Thaçi. Anëtarët votuan për këtë propozim.

Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj